

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja e vetme gjykuese Lumnije Krasniqi, me zyrtarin ligjor Leutrim Hoti, në çështjen penale kundër të akuzuarit **L.G**, për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.2005/14, datë 17.06.2014, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me dt.06.02.2018, në të cilën kanë marrë pjesë prokurorja e shtetit Shenaj Berisha, dhe i akuzuari L.G, më datë 06.02.2018, mori dhe publikisht shpalli, këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

L.G, i biri i S., dhe A., i lindur me dt.*data e lindjes...*, me vendbanim në P., lagja U. nr..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me ID:...

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 04.03.2014, rreth orës 15:00, në lagjen U. në P., i pandehuri me qëllim përdorimi pa autorizim ka poseduar substanca narkotike, ashtu që derisa ishte duke ecur është ndalur nga zyrtaret policore dhe gjatë kontrollimit, i është gjetur në posedim një cigare e punuar me dorë që përmban Kanabis (marihuan) në peshë prej 1.00 gram dhe një qese e mbushur me substancë narkotike të llojit Kanabis (marihuan), që përmban Tetrahidrokanibol dhe Nikotinë në peshë prej 0.69 gram, që në tersi përmban sasinë në peshë prej 1.69 gram, të cilat pas identifikimit nga policia janë sekuestruar,-

-me këtë i akuzuari ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së.

Prandaj, kjo Gjykatë, në bazë të nenit 4, 7, 17, 41, 43, 46, 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe nenit 248, 359, 361, 365, 366, 450, dhe 463 të KPPK-së, e:

G J Y K O N

Me dënim me gjobë, në shumë prej **300 (treqind) euro**, të cilin dënim i akuzuari është i detyruar ta paguajë, në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, Gjykata mund t'ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke ia llogaritur 1 (një) ditë burgim, me njëzet (20) Euro të gjobës.

Obligohet i pandehuri që ti paguajë shpenzimet procedurale aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, si dhe në emër të paushallit gjyqësorë të paguajë, shumën prej 20 (njëzet) €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzë në këtë Gjykatë, PP.II.nr.2005/14, datë 17.06.2014, kundër të akuzuarit L.G , për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datën 06.02.2018, gjatë së cilës seancë u dëgjuan prokurori i shtetit, dhe i akuzuari. Në këtë shqyrtim, prokurori i shtetit lexoi aktakuzën, dhe menjëherë të akuzuarit iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm.

I akuzuari në shqyrtimin fillestar, deklaroi se e ka kuptuar aktakuzën në tërësi, me vullnet të plotë dhe i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale për të cilën i vihet në barrë sipas aktakuzës së prokurorit të shtetit.

Prokurorja e shtetit Shenaj Berisha, lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari, deklaroi se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është në pajtueshmëri të plotë me dispozitat ligjore saktësisht me nenin 248 të KPPK-së, se është bërë në mënyrë vullnetare dhe ky pranim mbështet në faktet që i përmban aktakuza.

Nga pranimi i fajësisë në mënyrë të plotë dhe të vullnetshme nga i pandehuri gjykata në bazë të nenit 248 të KPPK-së, në seancën e shqyrtimit fillestar, me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari pasi që është bindur plotësisht se i akuzuari ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë dhe se i akuzuari e ka pranuar fajësinë pa presion dhe me vullnetin e tij të plotë.

Nga thëniet e vet të akuzuarit në shqyrtimin fillestar u vërtetuar se ai me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e akuzës së ngritur ndaj tij, ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale, si dhe nga vet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së, për të cilën akuzohet i akuzuari.

Andaj, gjykata të njëjtin e shpalli fajtor, pasi që gjeti se penalisht është i përgjegjshëm dhe e gjejkoj si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit të sanksionit penal, i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, andaj si rrethanë lehtësuese mori faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, qëndrimin korrekt në gjykatë, ndërsa gjykata nuk gjeti rrethana rënduese, ashtu që të njëjtit, i shqiptojë dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësisë penale, dhe se i njëjti do të ndikojë në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarit dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit konform nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, dhe të paushallit, është marrë konform nenit 450 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 248, 359, 361, 365, 366, 450, dhe 463 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
-Departamenti i Përgjithshëm-
P.nr.1319/14, dt.06.02.2018

Zyrtari Ligjor,
Leutrim Hoti

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Lumnije Krasniqi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve
nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.